

G4G:RBI Shqipëri

Vendndodhja:

Shqipëri

Numri i Projektit:

51349

Sektori i biznesit:

Institucione Financiare

Lloji i njoftimit:

Privat

Kategoria mjedisore:

Institucione Financiare

Data e miratimit:

02 dhjetor 2020

Statusi:

Nënshkruar

PSD publikuar më:

22 dhjetor 2020

Sipas pikës 2.6 të Seksionit III "Politika e Qasjes në Informacion", publikimi i kësaj DPS-je [Dokument Përmbledhës i Projektit] është shtyrë në përputhje me Pikën 1.4.4 të Direktivës për Qasjen në Informacion.

Përshkrimi i Projektit

Sigurimi i një garancie në monedhën vendase deri në vlerën prej 100 milionë Euro për llogari të Raiffeisen Bank Sh.a. Shqipëri (RBAL), që është një shoqëri aksionare me seli në Shqipëri. Garancia do të ketë periudhë fillestare maturimi prej 3 vjetësh.

Objektivat e Projektit

Garancia do të mbulojë riskun e bonove sovraane të Shqipërisë në monedhën vendase, që zotërohen nga klienti, duke i mundësuar RBAL të japë hua për sektorin privat në shuma shumëfish të vlerës së garantuar. Një vlerë në monedhën vendase e barasvlershme me të paktën 10 milionë Euro do t'i alokohet projekteve që promovojnë Tranzicionin në Ekonomi të Gjelbër (GET).

Ndikimi në Tranzicion

Pikëzimi ETI:70

Projekti do të vendosë në dispozicion kapacitete të reja të huadhënies për Sipërmarrjet e vogla dhe të mesme (SVM) dhe korporatat në Shqipëri. Projekti mbështetet në dialogun e politikave në kuadër të platformës së Nismës së Vjenës, përforcon bashkëpunimin bankar ndërkufitar dhe është në përputhje me aktivitetet e Bashkëpunimit Teknik (TC), që mbështetin autoritetet vendore të forcojnë dhe harmonizojnë kuadrin rregullator dhe mbikëqyrës për bankat, me ato të BE-së. Ndikimi i pritshëm i tranzicionit të projektit vjen nga cilësitë e Qëndrueshme dhe Konkurruese të Ndikimit në Tranzicion.

Informacion për Klientin

RAIFFEISEN BANK SHA

RBAL është klient ekzistues i BERZH dhe banka e tretë për nga madhësia në Shqipëri, ku zë 15% të tregut. RBAL ofron një gamë të plotë të produkteve dhe shërbimeve bankare në 4 sektorët kyç të biznesit në të cilët vepron, përkatësisht individët, bizneset mikro, bizneset e vogla dhe korporatat, dhe i shërben më shumë se 700.000 klientëve në vend.

RBAL me seli në Tiranë operon përmes 75 degëve në 44 qytete në të gjithë Shqipërinë, duke punësuar rreth 1.300 punonjës (fundi i vitit 2019). Gjithashtu, banka ka rrjetin më të madh të bankomatëve në vend. RBAL zotërohet në masën 100% nga Raiffeisen Bank International AG Austri (RBI).

Përmbledhja Financiare e BERZH-it

12.370.000.000,00 ALL

E barasvlershme me 100.000.000 Euro.

Kostoja e Përgjithshme e Projektit

12.370.000.000,00 ALL

E barasvlershme me 100.000.000 Euro.

Plotësueshmëria

Plotësueshmëria arrihet bazuar në një sërë faktorësh:

- BERZH-i siguron një instrument me impakt të madh që përmbush një hendek të tregut, përmes një strukture novatore financimi me terma tregtarë që nuk janë të disponueshëm nga pjesëmarrës të tjerë në treg.
- Përfshirja e BERZH-it në projekt ka për synim të sjellë ndryshime në kuadrin rregullator dhe mbikëqyrës për bankat.

- Projekti do të mbështesë angazhimin e një grupi të madh bankar të BE-së në rajonin e BERZH-it.

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

Kategorizuar FI (PMS 2019). RBAL do të ketë detyrimin të veprorë në përputhje me Kriteret e Performancës 2 dhe 4 të BERZH dhe të zbatojë Kriteret e Performancës 9 për huadhënien e siguruar për SME-të dhe korporatat në kuadër të projektit. RBAL duhet të zbatojë Procedurat e BERZH për Menaxhimin e Riskut Mjedisor dhe Social për huadhënien për bizneset mikro, SME dhe korporata, si dhe duhet t'i dorëzojë Bankës raporte vjetore. Financimi i BERZH-it mbështet kryesisht financimin e SME-ve dhe korporatave, që konsiderohen si financim me risk të ulët dhe të mesëm nga pikëpamja mjedisore dhe sociale, dhe klienti duhet të ketë një sistem të menaxhimit mjedisor dhe social në përputhje me këtë nivel risku.

Bashkëpunimi Teknik dhe Financimi i Granteve

Ky projekt është në harmoni me dialogun e vazhdueshëm të politikave në kuadër të Nismës së Vjenës. Një projekt i dedikuar i Bashkëpunimit Teknik në Shqipëri do të mbështesë harmonizimin e kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës për bankat në Shqipëri me standardet e BE-së.

Informacioni i Kontaktit për Shoqërinë

Rigers Kristo
Rigers.KRISTO@raiffeisen.al
+355 4 2381 381
www.raiffeisen.al
Raiffeisen Bank Albania "Blv."Bajram Curri", European Trade Center, Kati i 14,
Tiranë.Shqipëri

Përditësimi i fundit i PSD-së

22 dhjetor 2020

Të Kuptojmë Tranzicionin

Informacion i mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH-it për matjen e ndikimit të tranzicionit mundësohet [këtu](#).

Mundësitë për biznes

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhet me prokurimin) kontaktoni:

Tel:+44 20 7338 7168
Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH](#):

Tel: +44 20 7338 6794

Email: procurement@ebrd.com

Informacione të përgjithshme

Mund të bëni pyetjet të veçanta duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS-ja](#) dhe Kriteret përkatëse të Performancës (PR) përcaktojnë mënyrat se si BERZH-i zbaton angazhimet e veta për promovimin e “zhvillimit të fuqishëm dhe të qëndrueshëm nga aspekti mjedisor”. PMS-të dhe PR-të përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të jenë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankesave për të marrë dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket performancës mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe shkallën e rreziqeve dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH-i i kërkon klientëve të zbardhin gjithashtu informacionin e përshtatshëm mbi rreziqet dhe ndikimet e projektit ose që të kryejnë këshillime kuptimplota me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion për praktikën e BERZH-it në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) e BERZH-it promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Kujdesi i duhur për integritetin aplikohet për të gjithë klientët e Bankës për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rreziqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për hetimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe sjellje të jashtëligjshme në projektet e financuara nga BERZH-i. Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që dyshon mashtrim apo korrupsion duhet të dorëzojë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike në compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të trajtohen nga OCCO për ndjekje. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdo prej gjuhëve të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI-ja përcakton mënyrën se si BERZH-i e shpalos informacionin dhe këshillohet me palët e veta të interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe perceptimin më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH-it.

Mund të kërkonte informacion të veçantë duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies së Projektit (IPAM)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh. përmes mekanizmit të ankesave në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe institucionet mund të trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur të Llogaridhënies të Projektit (IPAM) të BERZH-it.

IPAM shqyrton problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëm, në mënyrë të pavarur. Qëllimi i Mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të bërjes publike; përcaktojë nëse Banka është në përputhje me [Politikën e vet Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së vet të Qasjes në Informacion](#); dhe kur gjen zbatim, të trajtojë çdo mospërputhje të verifikuar me këto politika, ndërkohë që parandalon mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutemi vizitoni faqen tonë të internetit të Mekanizmit të Llogaridhënies së Projektit për të dorëzuar një Kërkesë shqyrtimi përmes [formularit konfidencial në internet](#), me [postë elektronike](#), [postë apo telefon](#). IPAM është i disponueshëm për të diskutuar shqetësimet tuaja dhe t'i përgjigjet të gjitha pyetjeve që mund të keni lidhur me dorëzimin apo përpunimin e Kërkesave, në përputhje me [Politikën e Llogaridhënies së Projektit](#) dhe [Udhëzimeve](#). Identiteti i kërkuësve mund të mbahet i fshehtë, sipas kërkesës.